



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunes, kërkon nga Kuvendi i Komunës:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, nenit 12 të Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018, Rregullores 15Nr._____ e datës _____për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018 si dhe nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 13 të Rregullores për ndarjen së subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2021, të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT TË QYTETARËVE ME VENDBANIM TË PËRHERSHËM NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. Me këtë Vendim përcaktohet që shuma për subvencionimin e shërbimeve të Varrimit për qytetarët e Komunës së Lipjanit të jetë 210 € për një varrim.

II. Autorizohet , Kryetari i Komunës që të lidh Marrëveshje me shkrim me institucionet fetare që veprojnë në territorin e Komunës së Lipjanit për kryerjen e shërbimeve të varrimit konform dispozitave të këtij Vendimi dhe legjislacionit në fuqi .

III. Subvencionimi i shpenzimeve për shërbimet e varrimit do të bëhet për çdo person të vdekur për të cilin në bazë të ekzaminimeve mjekësore në pajtim me dispozitat ligjore është konstatuar vdekja . Në shërbimet e varrimit përfshihen : hapja e varrit, fletëljajmërimet (afishet), dërrasat, piramida, pastrimi i kufomës, mbulesa e kufomës dhe qefini.

IV. Kryetari i Komunës pas pranimit të raportit mbi vdekjet me dokumentacionin e bashkëngjitur nga ana e institucionit fetar nxjerr Vendim për ekzekutimin e pagesës në baza mujore.

V. Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhen nga buxheti i Komunës përkatësisht nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe do të derdhen në xhirollogaritë e Institucioneve Fetare përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit.

VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa

VII. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës .

VIII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-71876 i datës 27.11.2018.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 12 të Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018, Rregullores 15Nr. _____ e datës _____ për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.400-71876 e datës 27.11.2018, nenit 13 të Rregullores për ndarjen së subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008,

Qëllimi i miratimit të këtij Propozim-Vendimi është që të ndihmohen qytetarët përkatësisht familjet me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes duke u bazuar në kontributin që qytetarët japin për Komunën si taksapagues gjatë gjithë jetës së tyre .

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 400 - 9009
Lipjan, më 12.02.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

